



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / *Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta*

Ministry of Culture, Youth & Sports

Këshilli Kombëtar për Parandalimin dhe Sanksionimin e Dhunës dhe
Dukurive Negative në Ngjarjet Sportive

KOMUNIKATË PËR OPINIONIN PUBLIK

24 Shkurt 2023
Prishtinë

Këshilli për Sport – Komunikatë për Opinionin Publik

Ndërlidhur me çështjen e adresuar gjatë ditës së djeshme dhe sot nga mediet elektronike në Kosovë, të cilat i referohen shkrimeve të disa medimeve franceze, në të cilat flitet për kurdisjet e disa ndeshjeve të Superligës së futbollit të Kosovës;

Këshilli Kombëtar për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive, ashtu siç e ka njoftuar opinionin edhe me prononcimet e më hershme, ka kërkuar dhe do të angazhohet në vazhdimësi që çdo dyshim i ngritur për kurdisje të ndeshjeve sportive të hetohet nga organet përkatëse shtetërore, dhe përgjegjësit do të dalin para ligjit.

Me kërkesën e Këshillit për Sport, prokuroria e shtetit, në mbështetje të Policisë së Kosovës është duke u marrë me trajtimin e çdo dyshimi të ngritur për kurdisje të ndeshjeve sportive, duke përfshirë edhe rastin e publikuar në media.

Meqenëse rastet për dyshime të kurdisjeve janë në fazën e hetimeve, përfshirë këtu edhe bashkërendimin me autoritetet e Francës dhe organizatat ndërkombëtare të

sportit, ne si Këshill nuk mund të japim ndonjë informatë shtesë që mund të dëmtojë hetimet, mirëpo e përsërisim angazhimin tonë të palëkundur dhe të të gjitha autoriteteve tjera shetërore për hetimin e çdo dyshimi të ngritur për kurdisje të ndeshjeve sportive.

Me respekt,

Besim Kelmendi

Kryetar i Këshillit për Sport

Tel: +383 44 666 913 (edhe në Viber)

Email: keshillipersport@rks-gov.net

Web: <https://mkrs-ks.org/?page=1,176>